



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 04-228485

Nr.1027/5Prot.

Tiranë, më 22/12/2017

V E N D I M

Nr. 187, Datë 22/12/2017

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË VJORË "MBI AUDITIMIN
E RREGULLSHMËRISË FINANCIARE TË AKTIVITETIT EKONOMIK
NGA DATA 01.01.2016 DERI ME DATË 31.12.2016"**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori dhe Kryeaudituesi i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, nisur nga fakti se nga auditimi financiar i ushtruar në Bashkinë Vlorë janë konstatuar parregullsi, devijime materiale por jo të përhapura, për të cilat jemi shprehur në Raportin e Auditimit bashkëlidhur, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi auditimin e pasqyrave financiare të datës 31.12.2016" të ushtruar në Bashkinë Vlorë, sipas programit të auditimit nr. 1027/1 prot, datë 09.10.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. OPINIONI I AUDITUESIT

Drejtuar: Bashkisë Vlorë

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Bashkisë Vlorë, të cilat përbëhen nga bilanci i institucionit në 31 Dhjetor 2016, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e fluksit të parasë, burimet dhe shpenzimet lidhur me investimet, pasqyra mbi gjendjen dhe ndryshimet në aktivet e qëndrueshme si dhe amortizimin e tyre, pasqyra e lëvizjes së fondeve dhe shënimet shpjeguese.

Opinionin i kualifikuar i Grupit të Auditimit mbi pasqyrat financiare të Bashkisë Vlorë

Në opinionin tonë, Pasqyrat Financiare të Bashkisë Vlorë, përveç çështjeve të trajtuara në bazën për kualifikimin e opinionit, paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar në 31 Dhjetor 2016, performancën e tij financiare dhe fluksin e parasë për vitin respektiv në përputhje me Kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

Bazat për Opinionin

Grup i auditimit tërheq vëmendjen për kualifikimin e opinionit (ISSAI 1705) për disa çështje të pazakonta të konstatuara, të cilat janë materiale, me ndikim në vendimmarrjen e përdoruesit të pasqyrave financiare si:

- Pasqyrat financiare në pasqyrën e pozicionit financiar nuk reflektojnë saktë gjendjen e detyrimeve ndaj të tretëve. Konstatohet se nuk janë kontabilizuar dhe përfshirë detyrimet sipas vendimeve të formës së prerë të gjykatave ndaj 16 subjekteve për vlerën 35,714,176 lekë. Gjithashtu nuk janë kryer rakordime me “A...” Sha dhe “O...” Sha, për detyrimet e bashkisë në mbyllje të vitit 2015 (çelja) dhe në mbyllje të vitit 2016 si konfirmime të nevojshme për përcaktimin e tepricave të këtyre llogarive.

- Në pasqyrën e pozicionit financiar, llogaria e amortizimit të akumuluar të aktiveve, për projekte në fushën e ndërtimeve nga viti 2015 është mbartur pa mbështetur në dispozita ligjore në vlerën 26,769,471 lekë. Amortizimi i llogaritur për këto projekte, edhe për vitin 2016, në vlerën 1,886,900 lekë, ka rezultuar i pa mbështetur në dispozita ligjore.

- Në pasqyrën e pozicionit financiar, llogaritë e të drejtave ndaj të tretëve nuk paraqiten saktë sipas gjendjes së tepricave të llogarive analitike. Në këtë mënyrë, të drejtat ndaj të tretëve për taksa e tatime lokale nuk janë reflektuar në tepricën e llogaritë e arkëtueshme në fund të vitit, sipas pasqyrave të publikuara për debitorët për tatim taksat lokale për 2846 subjekte në shumën 267,451,000 lekë.

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI 1700¹ dhe ISSAI 1200²). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Administrimit të Veprimtarisë dhe Financave të Bashkisë Vlorë

Drejtimi i Bashkisë Vlorë është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me Kuadrin e Raportimit financiar të Sektorit Publik, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe kontrollin e brendshëm të nevojshëm për

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raportit të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

² Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali material, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të pasqyrave financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu dhënia e një opinioni mbi përputhshmërinë e aktivitetit të institucionit, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare të institucionit.

Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe përpunojmë riskun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, për shkak të gabimeve apo mashtrimeve, planifikojmë dhe kryejmë procedura auditimi sipas risqeve të identifikuara, dhe grumbullojmë evidencë të mjaftueshme e të përshtatshme për formulimin e opinionit tonë. Risku që vjen nga mos identifikimi i këtyre anomalive për shkak të mashtrimeve, është më i lartë se ai i gabimeve, sepse mashtrimi mund të përfshijë falsifikime, fshirje të qëllimshme, keqinterpretime, apo edhe mungesë të qëllimshme të kontrollit të brendshëm.

- Vlerësojmë nëse politikat kontabile të zgjedhura nga stafi drejtues janë të duhurat dhe të arsyeshme.

- Krijojmë një konkluzion final nëse çështjet rutine të kontabilitetit janë kryer në mënyrën e duhur dhe bazohemi në evidencën e marrë nga auditimi, për ekzistencën e ndonjë dyshimi material mbi ngjarjet apo kushtet që mund të çojnë në një dyshim edhe më të madh mbi aftësinë e institucionit për të funksionuar normalisht. Nëse ne arrijmë në konkluzionin se ekziston një pasiguri e arsyeshme, ne duhet të kushtojmë më tepër rëndësi këtyre çështjeve gjatë auditimit tonë, dhe **të modifikojmë opinionin**. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të institucionit.

- Vlerësojmë informacionin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë edhe shënimet, për të evidentuar nëse pasqyrat financiare përfaqësojnë transaksione rutinë dhe ngjarje të prezantuara drejt.

Ne komunikojmë me drejtuesin nëse, ndër çështjet e tjera, planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit dhe gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm, që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.

Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën.

Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

B. MASA ORGANIZATIVE

GJETJA 1

Për vlerësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, u testuan komponentët e vlerësimit sipas përcaktimeve të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit” i ndryshuar:

Mjedisi i kontrollit. Bashkia e Vlorë, nuk ka miratuar kodin e etikës profesionale për nivelin menaxhues dhe për punonjësit e tjerë të njësisë. Strukturat e Bashkisë, funksionojnë sipas detyrave të përcaktuara në rregulloren e brendshme mbi: “Organizimin e veprimtarisë së punonjësve të bashkisë”, miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 11, datë 29.03.2012, rregullore e cila nuk përcakton detyra për funksionimin e 4 Njësive Administrative të krijuara sipas reformës administrative dhe nuk pasqyron detyra të qarta për specialistët sipas drejtorive që operojnë.

Nisur nga rëndësia dhe risku për arkëtimin e detyrimeve lokale, struktura aktuale, në vlerësimin tonë, nuk jep siguri për rritjen e performancës për vjeljen e detyrimeve lokale.

Nuk janë miratuar gjurmët e auditimit sipas përcaktimeve të nenit 16, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.

Në Bashkinë Vlorë, kryejnë aktivitet biznesi gjithsej 4547 subjekte, nga të cilët janë evidentuar debitorë 2846 subjekte fizik/juridik dhe mbi 46 mijë familje objekt i taksave familjare. Menaxhimi i detyrimeve për taksat lokale. Nuk bëhet me programe elektronike specifike por në mënyrë manuale ose me programin ”Exel”.

Menaxhimi i riskut. Nga titullari i Njësies Administrative, nuk është caktuar koordinatori i riskut dhe për rrjedhojë nuk janë identifikuar sistemet e kontrollit me risk. Nuk është hapur regjistri i riskut dhe për rrjedhojë nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij, në kundërshtim me kërkesat e nenit 10, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.

Veprimtaritë e kontrollit. Në zbatim të kërkesave të nenin 22, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010, nga ana e titullarit të Bashkisë Vlorë, nuk janë nxjerrë urdhra me shkrim për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë së kontrollit.

Nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar Grupi i Menaxhimit Strategjik, në kundërshtim me kërkesat e nenit 27, të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010.

Informacioni dhe komunikimi. Informimi dhe komunikimi, realizohet sipas shkallës së strukturave, bazuar në rregulloren e funksionimit të brendshëm.

Monitorimi. Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit, përgjithësisht realizohet nëpërmjet organizimit të grupeve të punës ose komisioneve përkatëse, si në rastet për marrjen në dorëzim të punimeve të kontraktuara dhe në rastet e kontrollit në terren të subjekteve që ushtrojnë aktivitetin e biznesit etj.

Për monitorimin e sistemeve dhe vlerësimin e funksionimit të tyre, gjatë viti 2016, ka funksionuar zyra e auditimit të brendshëm në Bashkinë Vlorë.

REKOMANDOJMË

Bashkia Vlorë të marrë masat e nevojshme për implementimin e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit” i ndryshuar; -Të përpilohet rregullorja e re e funksionimit të brendshëm të Bashkisë Vlorë, bazuar në strukturën organizative të miratuar; -Të caktohet koordinatori i riskut, të identifikohen aktivitetet me risk dhe të merren masa për menaxhimin e tij; -Të riorganizohet në nivel Drejtorie aktiviteti i menaxhimit të vjeljes së detyrimeve për tatim taksat vendore dhe të përcaktohen detyra të qarta në rregulloren e funksionimit të brendshëm për sektorët dhe specialistët e kësaj strukture; -Të merren masa për programimin elektronik të aktivitetit për vjeljen e detyrimeve lokale si dhe për veprimet e mbajtjes së kontabilitetit financiar.

GJETJA 2

Buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2016 është miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 2, datë 04.02.2016, jashtë afateve ligjore. Të ardhurat dhe shpenzimet janë programuar gjithsej në vlerën 1,794,393 mijë lekë. Në total treguesit e buxhetit janë realizuar në masën 73%, ku treguesi “Investime” është realizuar me vlerën më të ulët prej 23%.

Në buxhetin e vitit 2016, nuk janë programuar pagesat e të gjithë detyrimeve sipas vendimeve të formës së prerë të gjykatave për 16 subjekte, ku nga shuma e detyrimeve të konstatuara prej 75,108,176 lekë, janë programuar për tu paguar 39,394,000 lekë ose më pak për diferencën 35,714,176 lekë, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 2, datë 6.02.2012 “Për procedurat standard të zbatimit të buxhetit”, pikat 101 dhe 102.

Janë detajuar fondet për sponsorizimin e tre subjekteve që janë shoqëri aksionare SHA me kapital 100 % të bashkisë për; “K.F Orikum”, “Parku Urban” dhe “Ujësjellësi” SHA.

Programimi i sponsorizimit të këtyre subjekteve të cilat janë organizuar dhe funksionojnë sipas kërkesave të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare”, është bërë pa analizuar më parë treguesit financiare të viteve paraardhës. Financimi i tyre, është bërë bazuar në situacionin faktik të vitit ushtrimor për diferencën e shpenzimeve me të ardhurat e realizuara, gjë e cila nuk është stimuluese për veprimtarinë e tyre.

-Për shoqërinë “K.F Orikum” SHA me aktivitet sportin e futbollit, është programuar sponsorizimi i aktivitetit të saj, në masën 100% të shpenzimeve pasi nuk janë programuar të ardhura nga kjo Shoqëri, në kundërshtim me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarë dhe shoqëritë tregtare” dhe ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenet 9/ç, 40/3 dhe 40/5.

REKOMANDOJMË

Programimi i financimit të humbjeve të subjekteve; “K.F. Orikum”, “Parku Urban” dhe “Ujësjellësi” SHA, të bazohet në analiza të treguesve ekonomikë, duke synuar rritjen e performancës së këtyre subjekteve.

Bashkia Vlorë, të përpilojë programe të qarta lidhur me financimin e aktiviteteve sportive veçanërisht të sportit të futbollit dhe të rishikojë, mundësinë e organizimit të këtij sporti në nivelin e shoqatave ose të klubeve sportive, në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9376, datë 21.04.2005 “Për sportin” i ndryshuar.

Të merren masa që të kontabilizohen të gjitha detyrimet ndaj të tretëve përfshi edhe detyrimet sipas vendimeve të formës së prerë të gjykatave dhe të programohet financimi i tyre në buxhetin e vitit 2018, në zbatim të kërkesave ligjore.

Brenda Muajit Mars 2018

GJETJA 3

Specialistët e Financës janë në varësi direkt të Drejtorit Ekonomik të Bashkisë që drejtohet nga nëpunësi zbatues. Janë të punësuar gjithsej 11 nëpunës specialistë të financës, dy magazinier dhe 1 (një) arkëtare. Pasqyrat financiare, janë përgatitur dhe firmosur nga specialisti i financës z. H.... H..... (nuk ka sektor finance), i cili nuk është emëruar si nëpunës zbatues, ku në rastin konkret është Drejtori Ekonomik, në kundërshtim me germën (b), pika 2, neni 12 dhe neni 15, të ligjit nr. 10296, datë 08.072010 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin”. Kontabiliteti mbahet në mënyrë

manuale ose në programin elektronik “Exel” pasi nuk përdoren programe elektronike financiare.

Nuk janë miratuar procedura për ndarjen e operacioneve dhe proceseve të punës për specialistët e financës, pasi rregullorja e Bashkisë Vlorë e miratuar me vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 11, datë 29.03.2012, nuk i përgjigjet strukturës së re pas reformës administrative.

Në organikë janë emëruar specialistë finance në njësitë administrative; Novoselë, Oriku, Shushicë dhe Qendër megjithëse nuk e kryejnë këtë aktivitet, pasi njësitë nuk kanë buxhet dhe bilanc me vete.

REKOMANDOJMË

Bashkia Vlorë, të marrë masa për ngritjen e Sektorit të Financës dhe Sektorit të Ardhurave Lokale, duke përcaktuar detyra të qarta për çdo pozicion pune, njëkohësisht të rishikohen emërtesat “Specialist Finance” në Njësitë Administrative: Novoselë, Oriku dhe Qendër me synim për të emëruar specialistët në pozicione reale pune me detyra të përcaktuara qartë.

Brenda Muajit Mars 2018

GJETJA 4

Në bilancin e vitit 2016 janë mbartur projekte nga ish- Komunitat në momentin e bashkimit të bilancit të vitit 2015, respektivisht: nga Ish- Komuna Shushicë janë 4 projekte me vlerë 3,795,000 lekë, ish- Komuna Qendër janë 4 projekte me vlerë 18,503,000 lekë, ish- Bashkia Oriku janë 9 projekte me vlerë 25,651,500 lekë dhe ish- Komuna Novoselë janë 2 projekte me vlerë 12,212,760 lekë, gjithsej 19 projekte me vlerë 60,162,260 lekë.

Nga analiza e projekteve të trashëguar nga ish- njësitë e shkrira, rezulton se këto projekte nuk janë shoqëruar me vitin e hyrjes së projektit dhe nuk janë të veçuar projektet e vëna në zbatim për ndërtim rrugësh, ndërtesa shkollash, ujësjellës, KUZ etj. me ato të pa vëna në zbatim.

Për këto projekte është llogaritur amortizimi në masën 5% e vlerës mbetur të projekteve, por në fakt nuk duhet të ishte llogaritur amortizim për projektet e ndërtimeve të vëna në zbatim, vlerë e cila duhet të ishte kaluar vlerës së objekteve të marra në dorëzim, mbështetur në Udhëzimin e KM nr. 2, datë 08.05.2003 ”Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit” pika C “Të ndryshme”.

Në 1(një) rast nga ish- Komuna Novoselë është trashëguar në llogarinë nr. 202 “Projekte” në zërin “Të tjera” është mbartur vlera 9,812,760 lekë e pa analizuar , por e mbartur prej vitesh.

REKOMANDOJMË

Nga nëpunësi zbatues, të merren masa për sistemimin e llogarisë nr. 202 ”Studime e projekte”, për sa është llogaritur amortizim në masën 5% të vlerës mbetur të projekteve dhe në bilancin e vitit 2016 është llogaritur gjithsej sipas pozicionit financiarë në llogarinë nr. 219 ”Amortizim i aktiveve të patrupëzuara” në vlerën 28,656,371 lekë. Vlera fillestare e projekteve sipas analizës së kësaj llogarie të sistemohet duke rritur vlerën e objekteve të marra në dorëzim. Njëkohësisht të analizohet vlera e mbartur në zërin “Projekte të tjera” e trashëguar nga ish- Komuna Novoselë me vlerë 9,812,760 lekë.

Brenda Muajit Mars 2018

GJETJA 5

Programimi i të ardhurave nga tatim taksat lokale, është miratuar me Vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 2, datë 04.02.2016 për vlerën totale 1,146,132 mijë lekë, nga e cila realizuar në shumën 538,417 mijë lekë ose 50% e programimit.

Në mosrealizimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, ndikim të madh ka mos realizimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë, e cila është programuar në shumën 384,687 mijë lekë dhe realizuar 37,748 mijë lekë ose 10% e programimit me ndikim në totalin e të ardhurave në masën 32%.

Detyrimet progresive të pa vjela për taksat e tarifave vendore deri më datën 31.12.2016, janë në shumën 445,633 mijë lekë, nga të cilat:

-267,451 mijë lekë nga 2846 subjekte të biznesit të vogël dhe të madh,

-131,267 mijë lekë taksë mbi tokën bujqësore nga 11452 familje dhe

-46,915 mijë lekë taksat familjare nga 46434 familje.

Në pasqyrat financiare të vitit 2016, nuk janë kontabilizuar dhe pasqyruar debitorët për taksat lokale.

Për vjeljen e detyrimeve lokale, u janë bërë njoftim subjekteve dhe më pas janë dërguar shkresa për bllokimin e llogarive Bankare, për sekuestro të mjeteve të transportit pranë Drejtorisë së Kontrollit dhe Shfrytëzimit të Automjeteve, ZVRPP për vendosjen e barrës së pasurisë dhe Qendrës Kombëtare të Biznesit, por nuk është vazhduar me marrjen e masave të tjera shtrënguese si: bllokimi i aktivitetit të biznesit, sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal, sipas kërkesave të nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjin nr. 164/2014, datë 4.12.2014.

Nga Bashkia Vlorës, nuk janë lidhur kontrata mbi përdorimin e sipërfaqes për aktivitetin e shfrytëzimit minerar për 7 subjekte të licencuara, me efekt mungesë të ardhurash në shumën 214,044 mijë lekë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", pikat 6, 9, 11, 12, lidhja nr. 2.

REKOMANDOJMË

Bashkia Vlorë, të marrë masat e nevojshme për të rritur performancën e vjeljes së detyrimeve për taksat e tarifave vendore.

Të riorganizojë strukturën e vjeljes së të ardhurave, duke e modernizuar atë me aplikimin e programeve elektronike për evidentimin kontabël të detyrimeve lokale.

Të centralizohet struktura e borxhit tatimor në nivel bashkie, pasi Njësitë Administrative nuk kanë kapacitete e duhura për ndjekur detyrimet tatimore lokale.

Brenda Muajit Mars 2018

GJETJA 6

Gjatë vitit 2016, Drejtoria Arsimore, ka transferuar në Drejtorinë e Shkollave vlerën e inventarit në shumën 2,037,960 lekë, bazuar në fletë daljen e Drejtorisë Arsimore nr. 156/1, datë 16.06.2015.

Transferimi i këtyre inventarëve, nuk është bërë bazuar në akt dorëzimi të firmosur midis dy institucioneve (*marrësi Bashkia Vlorë dhe dorëzuesi Drejtoria Rajonale Arsimore Vlorë*), por u janë dorëzuar direkt Drejtorive të Shkollave.

Këto inventarë, janë bërë hyrje me vonesë në magazinën e Bashkinë Vlorë sipas fletë hyrjes nr. 2, datë 19.01.2016, në momentin që janë konstatuar tepër nga procesi i inventarizimit të fund vitit 2016, në kundërshtim me kërkesat e UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar, pikat 37, 38, 39, 42.

REKOMANDOJMË

Bashkia Vlorë, të bashkëpunojë me Drejtorinë Arsimore duke i kërkuar kësaj të fundit me shkresë zyrtare çdo vit, që furnizimet me bazë materiale të shkollave, të bëhen nëpërmjet Bashkisë Vlorë me akt dorëzim të rregullt duke i bërë hyrje dhe dalje në kohë në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” i ndryshuar.

Për të evidentuar furnizimet inventariale të bëra gjatë vitit nga Drejtoria Arsimore, të organizohet kontabiliteti duke përdorur llogarinë e ndërmjetme 45 “*Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit*”, në zbatim të planit kontabël të miratuar me VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njëjsteve që varen prej tyre”, i ndryshuar.

Menjëherë

GJETJA 7

Struktura organizative e Bashkisë Vlorë dhe niveli i pagave, janë miratuar me vendime të Këshillit të Bashkisë nr. 1, datë 4.02.2016, ndryshuar me vendimin nr. 10, datë 02.03.2016.

Për llogaritjen e shtesës së vjetërsisë në punë të punonjësve, nuk disponohen dokumente të konfirmuara nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore për vjetërsinë në punë të çdo punonjësi që është përfitues i shtesës mbi pagë për vjetërsi pune.

Mungesa e të dhënave mbi vjetërsinë në punë të punonjësve, është edhe në vitet paraardhëse me pretendimin se shtesa e pagës për vjetërsi pune, është ndjekur në vite nga specialistja e pagave. Referuar listë pagesës së muajit Dhjetor 2016, shtesa e pagës së punonjësve për vjetërsi në punë është në vlerën 772,973 lekë ose 4,6 % e pagës bruto. Listë pagesat janë të firmosura vetëm nga specialistja e pagave z. J..... M....., kurse përmbledhësja e pagave për çdo muaj është e firmosur nga Specialistja e pagave, kontabilisti, Drejtori i Financës dhe Titullari i Bashkisë.

Në asnjë rast, nuk janë firmosur listë-pagesat dhe as përmbledhësja e tyre nga Drejtori i Burimeve Njerëzore, në kundërshtim me kërkesat e Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 10, datë 02.03.2016, VKM nr. 165, datë 2.03.2016 “Për grupimin e njëjsteve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njëjsteve të vetëqeverisjes vendore”, pika 6 dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pikat 69 dhe 70.

REKOMANDOJMË

Bashkia Vlorë të marrë masa për të ndryshuar procedurën e përgatitjes dhe aprovimit të listë-pagesave të punonjësve, në përputhje me kërkesat ligjore.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Vlorë, në zbatim të nenit 15, shkronja (i) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ISSAI 1600 dhe nenit 25 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, në bazë të një programi auditimi të miratuar nga Titullari i Bashkisë, të auditojë më tej këtë konstatim. Bazuar në të dhënat zyrtare nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore mbi vjetërsinë në punë të punonjësve, nivelit të diplomës dhe shtesës së pagës për pozicion pune sipas miratimit me vendime të këshillit të bashkisë, të verifikojë në vite diferencat e mundshme me dëm ekonomik dhe të

nxjerrë përgjegjësitë përkatëse.

Brenda Muajit Mars 2018

GJETJA 8

Disa llogari të pasivit të bilancit financiar që pasqyrojnë kërkesa për arkëtime, nuk kanë pasur ndryshime gjatë vitit 2016, gjendja në çelje janë të pa ndryshuara deri në fund të vitit. Konkretisht llogaria nr. 4341 “*Të tjera Operacione me shtetin kreditor*”, është paraqitur me të njëjtën tepricë si në çelje dhe në mbyllje të vitit ushtrimor për 1,748,591 lekë, llogaria nr. 480 “*Të ardhura për tu rregulluar ose klasifikuar*” është paraqitur me të njëjtën vlerë 15,922,745 lekë, llogaria nr. 475 “*Të ardhura për tu regjistruar në vitet pasardhëse*“, është paraqitur me të njëjtën vlerë 77,600,727 lekë.

Këto llogari kanë si kundra parti në aktiv të bilancit debitorë të natyrave të ndryshme si debitor për gjoba të IMTV në vlerën 61,682,000 lekë, debitorë të ish-komunave 25,097,720 lekë dhe debitorë për detyrime të rekomanduara nga auditimet e KLSH-së në vit, nga viti 2008 për shumën 8,492,343 lek.

REKOMANDOJMË

Drejtoria Ekonomike të marrë masa për vjeljen e detyrimeve ndaj të tretëve në shumën totale 95,272,063 lekë dhe veçanërisht nga IMTV e Bashkisë për vjelljen e gjobave në vlerën 61,682,000 lekë.

Brenda Muajit Mars 2018

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R